REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 982/20
Datë/Datum. 20.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS, Adresa e AK: *RR.*TREPQËS, NR.2, Qyteti: PRISHTINË, Kodi Postar: Personi Kontaktues: Nexhmi Mekolli, E-mail: nexhmi.mekolli@rks-gov.net

Për: Aktivitetin e Prokurimit; me Numër te prokurimit; 616-20-6478-2-2-1,dhe numër te brendshëm ; 616 20 149 221

Sa i përket tenderit për: Implementimin e platformës digjitale E-Shkollori

Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

- **NSH SPINP Agency**
  (Emri i operatorit ekonomik)
- Rr. Mujë Krasniqi, C7, H.3, nr. 4
  (Adresa e OE)
- *Prishtinë, Republika e Kosovës*
  (Selia)

info@spinpagency.com +38349511411
(Adresa elektronike) *(Nr i telefonit)*

Armend Aliu
(Drejtori) *(Nënshkrmi)*

Prishtinë, Republika e Kosovës *20.11.2020*
(Vendi) *(Data)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Komuna e Prishtinës me date 15.10.2020 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Implementimi I platformës digjitale E-Shkollori tenderi i udhëhequr me:

- Numër të prokurimit: 616-20-6478-2-2-1,dhe nr te brendshëm ; 616 20 149 221
- Procedure e hapur,
- Kontrate publike
- Shërbime, Vlerë e mesme.
- Vlera e parashikuar e kontratës 32,000.00 euro.
- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim ka qene me date ; 26.10.2020 në ora 14:00:00, Vendi: ne platformën elektronike te prokurimit dhe ne Komuna e Prishtinës - kati i I nr. 214.

Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 26.10.2020 ne ora 14;00 , ne platformën elektronike te prokurimit dhe ne ndërtesën e komuna e Prishtinës - kati i I nr. 214.

Me datë 02.11.2020 përmes platformës se e-prokurimit jemi Njoftuar per Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 21.05.2020 Autoriteti kontraktues ka marre Vendim per anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se; Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe vazhdon me arsyetimin se ;

Specifikacioni teknik i dhënë ne dosjen e tenderit ne Aneksin 1, nuk përmban të gjitha elementet e duhura për implementim e platformës digjitale te E-shkollorit.

Ne specifikimin teknik nuk është parapare:

- Hostimi i te dhënave (element i domosdoshëm)
- Videoja udhëzuese per secilin modul (element i domosdoshëm)
- Moduli i gjurmimit te virusit covid-l9 (element i domosdoshëm)

Te pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues te publikuar te datës 02.11.2020, me date 06.11.202, kemi parashtruar Kërkese per Rishqyrtim te Vendimit te AK-së per rezultatin e tenderit.
Me date 11.11.2020 kemi pranuar Vendimin per refuzimin e Kërkesës per rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja e tenderit është bere ne vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar ne Njoftimin per kontrate. Procesi i hapjes është zhvilluar konforme Ligjit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

Nuk kemi pranuar Njoftimin per eliminim nga aktiviteti i prokurimit.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Me date 06.11.2020, kemi parashtruar Kërkesë per rishqyrtim te Vendimit te AK-se lidhur me rezultatin e tenderit.
Me date 11.11.2020 kemi pranuar Vendimin per refuzimin e Kërkesës per rishqyrtim me arsyetimin se:

Pretendimet e juaja qe kundërshtojnë arsyet e anulimit te aktivitetit te prokurimit janë te pa bazuara, pasi qe te gjithë njohësit e kësaj lëmie konsiderojnë se te njëjtat janë te domosdoshme per zbatimin profesional te këtij aktiviteti.
Te pakënaqur me Vendimin dhe arsyetimin e AK-se do te ushtrojmë ankese me pretendime te njëjta.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues per rezultatin e aktivitetit te prokurimit dhe Vendimin per refuzimin e Kërkesës per rishqyrtim te Vendimit te AK-se, dhe në pajtim me nenin 109 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së parashtroj këtë ankese kundër:

- Vendimit per refuzimin e Kërkesës per rishqyrtim te Vendimit te AK-se (Vendimi me p/n i datës 11.11.2020).

dhe

- Njoftimin për Anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull të kontratës;

"Implementimi i platformës digjitale E-Shkollori "

Pretendojmë se AK: Komuna e Prishtinës përmes Komisionit per vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *(në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;***

- Neni 1, Qëllimi,
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
- Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,
- Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,
- Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtese.

II. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

- Neni 44, Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Shkeljet e pretenduara të:

- **Të dispozitave të LPP-së.**

- **Neni 1, Qëllimi**

Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të anuluar aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe legjislacionit dytësor te prokurimit, ka vepruar ne kundërshtim me neni 1 , paragrafin 1 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 1 , paragrafit 2 të këtij Ligji, organet kompetente te AK –se dhe Zyrtaret e prokurimit janë të obliguar që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të kujdesen për qëllimin e këtij Ligji.

Në vijim po citoj dispozitat e Nenit 1. Paragrafi1, 2 dhe 3 të këtij ligji;

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

- Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Duke u bazuar në rrjedhat e procedurës së inicimit, zhvillimit, vlerësimit, dhe rezultatit te aktivitetit te prokurimit pretendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim te dispozitave te Nenit 1 te LPP-se.

- **Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet që të anuloj aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se ne specifikimin teknik nuk është parapare:

- Hostimi i te dhënave (element i domosdoshëm)

AA

- Videoja udhëzuese per secilin modul (element i domosdoshëm)
- Moduli i gjurmimit te virusit covid-l9 (element i domosdoshëm)

ka vepruar ne kundërshtim me nenin 6 te LPP-se.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 te këtij ligji.

➢ *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Pretendojmë se AK me vendimin e vet për per te anuluar aktivitetin e mëtejmë te prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me obligimin ligjor qe buron nga neni 6 i LPP –se i cili decidivisht obligon AK; qe te siguroj qe fondet publike dhe burimet tjera publike te përdoren ne mënyrën efikase, racionale dhe ekonomike.

➢ ***Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se:

Ne specifikimin teknik nuk është parapare :

- Hostimi i te dhënave (element i domosdoshëm)
- Videoja udhëzuese per secilin modul (element i domosdoshëm)
- Moduli i gjurmimit te virusit covid-l9 (element i domosdoshëm)

Ne vijim te kësaj kërkese do te përpiqemi qe te argumentojmë pretendimin ankimor se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit te tenderit ka vepruar ne kundërshtim me vlerësimin teknik te tenderit.
"Spinp Agency" ne dosjen e tenderit ka ofruar dëshmi te mjaftueshme dokumentare mbi hostimin e te dhënave si dhe ka shpreh gatishmëri per hartimin e Videos Udhëzuese per secilin modul.

1. **Hostimi I te dhënave (element i domosdoshëm)** –

Sa i përket kësaj pike, na lejoni te theksojmë qe gjitha platformat, webfaqet, sistemet qe janë te bazuara ne web (pra, siç është edhe kjo platformë ku gjithë mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, etj. kanë mundësi të qasen nga webi), edhe kjo platformë ka qenë dhe është e hostuar në ndonjë kompani dhe gjithsesi që kjo është nënkuptuar në mënyrë automatike dhe logjike, sidomos nga AK-K.Prishtinës, por gjithsesi edhe nga ana jonë si OE ofertues dhe e vetkuptueshme se ne e kemi marr parasysh që platforma e-shkollori duhet hostuar dhe për këtë ne veqse kemi dhënë zgjidhjet tona dhe kemi akceptuar që do të realizojmë gjitha shërbimet sa I përket platformës ne fjale, duke përfshirë edhe shërbimin e hostimit në ofertën tonë, por edhe tani përmes kësaj Ankese, Ne-SPINP Agency garantojmë dhe sigurojmë AK-K.Prishtinës dhe poashtu edhe anëtarët e OSHP-së apo komisionin vlerësues, siç kemi siguruar dhe garantuar edhe në dosjen tonë të tenderit të dorëzuar pranë AK, që kompania jonë do të hostoj gjitha të dhënat dhe komplet platformën e-shkollori tek serverët tanë dhe atë pa ndonjë kosto apo çmim shtesë për Komunën e Prishtinës.
Pra, kjo pikë asesi se nuk është element I domosdoshëm, siq AK-K.Prishtinës ka pretenduar në vendimin e saj për anulimin e tenderit dhe kjo sigurisht që është edhe shkelje ligjore flagrante nga AK - K. Prishtina, që të anuloj procedurën

tenderike dhe në këtë mënyrë te diskriminoj OE tonë, si ofertues dhe atë me çmim shumë të arsyeshëm (por edhe me çmim real te tregut), si edhe me garancën dhe sigurinë e plotë të ofruar nga ana jonë, për realizimin e gjitha shërbimeve në fjalë në mënyrën me profesionale dhe më të mirë të mundëshme.

2. **Videoja udhëzuese për secilin modul (element i domosdoshëm)-**
Platforma e-shkollori, për të cilën AK-K.Prishtinës ka shpallur këtë procedurë tenderike, është një platformë që është zhvilluar nga një OE, i cili po ashtu ka qenë ofertues në këtë procedurë tenderi dhe kjo platforme është në funksion dhe në përdorim të plotë nga gjithë të Mësimdhënësit, nga gjitha Shkollat e K.Prishtinës, si dhe nga Nxënësit e Prindërit e gjitha shkollave të K.Prishtinës, pra kjo në mënyrë automatike, logjike por edhe reale, na bënë të nënkuptojmë që gjithë përdoruesit e Shkollave të K.Prishtinës (palët e posa përmendura), veqse kanë njohuri të përdorimit të platfromës në fjalë (E-Shkollori) dhe kanë përfituar trajnime qysh kohë më parë (për këtë ne kemi dëshmi të prekshme dhe secili banor i Qytetit të Prishtinës në fakt që ka një ndërlidhje me Sistemin Shkollor të Mesëm dhe të Ulët ka dëshmi, pasi që edhe familjarë dhe njerëz të afërm tonë që punojnë në institucionet shkollore të K.Prishtinës, e përdorin plaftformën në fjalë dhe të gjithë ata janë trajnuar për përdorimin e kësaj platforme) dhe në këtë mënyrë ky pretendim i AK-K.Prishtina, është pretendim diskriminues, duke u munduar të Anulojne procesin dhe në këtë mënyrë ta gjejnë një rrugë të vetmen qe ju ka mbetur për të na eleminuar neve si OE dhe për ti dhënë mundësinë OE të caktuar në procedurat tjera të përsëritura të fitoj projektin në fjale (pra duke favorizuar të njëjtin).
Kështu që, kjo pikë nuk do të ishte një element I domosdoshem siç edhe AK-K.Prishtinës ka pretenduar në vendimin e saj per anulimin e tenderit dhe të njëjtin e ka bërë vetëm per shkak të faktit, që ne si OE kemi ofertuar në këtë procedurë tenderi dhe kemi dalë me çmimin më konkurrues dhe më të lirë nga gjithë ofertuesit tjerë (i cili, po e përsëris prap që është çmim real i tregut aktual në këtë fushë), por edhe njëkohësisht kemi qenë shumë të përgjegjshëm në ofertën tonë, duke I plotësuar gjitha kërkesat teknike dhe administrative të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe në këtë formë edhe kemi pamundësuar që OE i caktuar (i cili e ka zhvilluar platformën e-shkollori), të mund të jetë fitues dhe si reuzultat i kesaj arsyeje ka ardhur deri te anulimi në tërësi i procedurës tenderuese në fjalë, duke na diskriminuar, por edhe duke na DEKURAJUAR NË PJESMARRJE NË TENDERIMET PUBLIKE, DHE ATË JASHTËZAKONISHT NË MENYRË DHE FORME TE KEQE dhe me arsye të tilla, NË TËRËSI JOLIGJORE DHE DISKRIMINUESE.

3. **Moduli I Gjurmimit te Virusit Covid-19 (element i domosdoshëm) –**
Kjo është një pikë me të cilën AK-K.Prishtinës ka pretenduar që është arsye se perse duhet ta anuloj procedurën e tenderit në fjalë, mirëpo në të njëjtën kohë sa është joprofesionale dhe absurde, po aq është edhe qesharake, sepse të pretendohet që në një platformë shkollore të ketë një modul I cili bënë gjurmimin e virusit covid-19, sigurisht që kjo tregon qartë që AK-K.Prishtinës dëshiron që në mënyrë flagrante dhe të njëanshme të bëjë shkelje dhe të na eliminoj neve si OE ofertues më të lirë, në pamundësi të shpalljes së ofertës dhe kompanisë tonë si të papërgjegjshëm (për shkakun që Kompania jonë i plotëson gjitha kriteret e D.T., siq e kemi cekur edhe në pikat mëlartë) dhe kështu vendosin që përmes këtyre pikave-arsyeve joligjore edhe të anulojnë procesin e tenderit në tërësi.
Përgjatë gjithë kësaj kohe të pandemisë, që nga muaji Mars 2020 dhe deri në datën e sotit, ne si OE konkurues dhe me përvojë të gjatë në fushën e IT-se, nuk kemi dëgjuar, por as nuk kemi hasur që diku në ndonjë vend të botës është

përdorur një modul i tillë, në një platformë shkollore, ku do të mundësonte gjurmimin e virusit covid-19.

Vet emërtimi I platformës shkollore, nënkupton që është një platformë që iu mundëson gjitha instancave arsimore-shkollore që të zhvillojnë procesin e mësimit dhe që të digjitalizohet procesi i mësimit, mirëpo të pretendohet se një platformë e tillë në fjalë të ketë modul të gjurmimit të virusit, besojmë që është asgjë më pak ose më shumë, sesa tentim që në mënyrë shume joligjore të anulohet ky tender dhe në mënyrë direkte te diskriminohemi ne si OE, por edhe te favorizohet një tjetër OE si ofertues në këtë procedurë, por edhe çfarë është me e rëndësishmja ajo që të dëmtohet buxheti I RKS (për më shumë se dyfishi i shumës sonë të ofertuar), duke keqpërdorur fondet publike në këtë rast, për shkak të diferences së çmimit që kemi ofertuar ne si Operator Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë tenderi.

Ne si OE, prap përmes kësaj Ankese, sigurojmë AK-K.Prishtines (dhe komisionin vlerësues të OSHP), se do ta implementojmë një modul tipit (O.S) dhe që do të mund të shërbejë si modul për covid-19, siq AK ka pretenduar, për gjitha palët e ndërlidhura në këtë platformë, dhe atë implementim do ta bëjmë pa asnjë kosto dhe çmim shtese për AK-K.Prishtinës, përveq atij çmimi që ne kemi ofertuar dhe kësisoj nuk do të kishte nevojë fare që të anulohet procesi i tenderit dhe të diskriminohemi dhe dekurajohemi për aplikime në procese tenderuese, nga Institucionet e RKS.

Ne si OE, te super kualifikuar në fushën e IT-së dhe me përvojë të gjatë në fushën e zhvillimit të softwereve dhe programeve edhe më komplekse dhe për shumë e shumë Institucione, Agjencione dhe Organizata Shtetërore, edhe pse nuk e shofim të arsyeshme implementimin e një moduli të tillë për covid-19 (O.S), prap garantojmë dhe sigurojmë AK-K.Prishtinës, që do të implementojmë modulin në fjalë dhe në këtë formë procedura e tenderit do të mund të vazhdoj dhe jo të anulohet, pasi që fundi i fundit, AK-K.Prishtinës, edhe nuk ka të drejtë të anulimit të proceseve tenderuese në këtë formë dhe mënyrë, ku pasi të jenë hapur ofertat dhe kur nga ato oferta, egziston vetem 1 OE ofertues i përgjegjëshëm dhe këtë duhet bërë vetëm duke bërë pyetje dhe kërkesë me shkrim, por edhe pas rekomandimit dhe përgjegjes me shkrim nga institucionet përgjegjëse (krpp), ose për atë duhet të ketë një arsye shumë bindëse dhe serioze (të cilat edhe janë të specifikuara në ligjin e Prokurimit Publik-LPP, por edhe te RUOPP-se dhe jo të tilla, që AK në fjalë ka pretenduar.
Si përfundim ne si OE zotohemi se do ti realizojmë keto pika dhe pa kosto shtesë, në mënyrë që ky proces i tenderit të vazhdoj tutje me implementim dhe jo të anulohet në tërësi dhe të fillohet me implementimin e platformës në shkolla, duke marr parasysh edhe kohën e veshtirë dhe nevojën imediate që kanë shkollat (nxënësit në veçanti, por edhe mësimdhënësit dhe prindërit, etj.) që të kenë një platformë të tillë, sa më shpejt në funksion të plotë dhe jo të vonohet me procedura të tejzgjatura të mëtutjeshme.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

- **Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**

Pretendojmë se Komisioni për rivlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të anuluar aktivitetin e prokurimit ka vepruar

në kundërshtim me neni 62 , paragrafin 1, dhe 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.
LPP rregullon kushtet dhe rrethanat se kur Autoritetin kontraktues duhet te përfundoj një aktivitet te prokurimit.

Citoj dispozitat e nenit 62 te LPP-së;

1. ***Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:***

   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. ***Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:***

   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

   2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 te LPP-se, shohim qarte se Autoriteti Kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara ne dispozitat e LPP-se.

➢ Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Pretendojmë se Komisioni për rivlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të anuluar aktivitetin e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 72 , paragrafin 1, 2, dhe 3 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.
LPP obligon Autoritetin kontraktues ne rastet kur informacioni apo dokumentacioni qe duhet te dorëzohet nga operatoret ekonomik është ose duket te jete jo i plote ose i gabuar ose kur mungojnë dokumentet specifike , autoriteti kontraktues duhet te kërkoj nga operatoret ekonomik qe te ,plotësojnë sqarojnë apo kompletojnë informacionin.
Pretendojmë se AK nuk ka shfrytëzuar këtë obligim ligjor qe te kërkoj sqarim nga OE "Spinp Agency" lidhur me Hostimin e te dhënave ,Videon udhëzuese per secilin modul si dhe sqarim lidhur me Modulin e gjurmimit te virusit covid-l9.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 72 te LPP-se, shohim qarte se Autoriteti Kontraktues e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara ne dispozitat e nenit 72 te LPP-se.

II. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

➢ Neni 44, Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të anuluar aktivitetin e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 44.6 te Rregullave dhe UOPP.
Rregullat dhe UOPP ne nenin 44.6 dhe 44.7 përcaktojnë kushtet se kur mund te anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes se tenderit.
Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 44.6 dhe 44,7 te Rregullave dhe UOPP:

44.6 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* **mund** të anulohet për arsyen e mëposhtme:
(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Citoj nenin 44.7 te Rregullave dhe UOPP:

44.7 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(i)asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(ii)asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm

(iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3;

(iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;

(vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; ose

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

(x) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit nga KRPP;

(xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është I pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP

Duke u bazuar ne nenin 44.6 dhe 44.7 te Rregullave dhe UOPP shohim qarte se AK ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e këtyre rregullave .
Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga organi kompetent i AK- që pas shqyrtimit te kësaj kërkese të:

- *Të aprovoj Ankesën si të bazuar,*
- *Të anuloj, Vendimin per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim dhe Vendimin e AK per anulimin e aktivitetit te prokurimi,*
- *Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit dhe LPP si dhe Rregullat dhe UOPP.*

Mbetemi me shpresë se ankesa e OE "Spinp Agency" do të shqyrtohet pozitivisht.

Me nderime,
Armend Aliu
NSH Spinp Agency
Prishtine

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani kemi pasur dëme materiale ne vlere prej 250 euro per përgatitjen e Kërkesës per rishqyrtim dhe Ankesës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë".*
b) *një kopje te Vendimit te AK-së.*
c) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
d) *një kopje te kerekses per rishqyrtim te Vendimit te AK-se,*
e) *një kopje te Vendimit per refuzimin e kërkesës.*

AA.